



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Kryetari i Komunës
01.Nr. 104/02-20822/2017
Kaçanik, 29.06.2017

Në mbështetje të Vendimit të Kuvendit, 01.Nr.400-2155/1, të datës 27.01.2017 si dhe Rregullores Nr.06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Komuna e Kaçanikut, bënë:

THIRRJE PËR APLIKIM PËR SUBVENCIONE

Në fushën e Kulturës, në organizimin e aktiviteteve të Javës së Diasporës (29 korrik 2017), dhe Ditës së Dëshmorëve (10 gusht 2017).

Të drejtë aplikimi kanë të gjitha Shoqëritë Kulturore- Artistike dhe OJQ-të të cilat janë të regjistruara në Komunën e Kaçanikut - Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës, të cilat janë të dëshmuara për promovimin, ruajtjen dhe kultivimin e vlerave tradicionale, gjithnjë duke u bazuar në plan programin e tyre vjetor për vitin 2017 dhe në politikat programore të Sektorit për Kulturë.

Kërkesa për aplikim për të gjithë aplikantët duhet të përmban:

- Qëllimin e kërkesës/projektit;
- Projekt Propozimi bashkë me koston totale dhe kosto që kërkohet nga Komuna;
- Plotësimi i Formularit për aplikim (shkarko aplikacionin <http://kk.rks-gov.net/kacanik>
Kliko : SHPALLJET -----APLIKACIONET -----FORMULARI PËR APLIKIM - KULTURE, RINI, SPORT)

Kërkesës duhet ti bashkëngjiten edhe dokumentet :

- Certifikata e numrit të regjistrimit të organizatës;
- Certifikata e numrit fiskal të organizatës;
- Vërtetimi regjistrimit pranë Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës në Kaçanik;
- Letërnjoftimi i personave/aplikantit /që përfaqëson organizatën;
- Xhirollogaria dhe dëshmia e bankës në emër të organizatës;
- Dëshmi se nuk ka obligime organizata ndaj ATK;
- Dëshmi për pagesën e taksave komunale.

Data e aplikimit është nga 30.06.2017 deri 15.07.2017.

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në objektin e Komunës së Kaçanikut, Zyra pritëse (sporteli nr. 5 nga ora 08:00-16:00 çdo ditë pune.)

Vërejtje:

- *Aplikacioni i cili nuk përmban të dhënat e kërkuara dhe dokumentacionin përkatës të kërkuar nuk do të shqyrtohet;*
- *Konkuresit të cilët nuk kanë përmbyllur avanset e mëparshme ndaj këtij institucioni, nuk do të merren në shqyrtim;*
- *Aplikacionet të cilat dorëzohen jashtë afatit të kërkuar nuk do të shqyrtohen.*

